

## AKT THEMELIMI

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “SANPAOLO SHPK”

Sot, më datë 07/01/2025

**Z.Pavlin Kalusha**, shtetas shqiptar, lindur me 15/03/1979, në Puke banues në Rrugën “Mustafa Matohiti, Pallati nr. 5, Ap 2/3, Tirane, mbajtës I dokumentit pashaporte me nr. Personal H90315260T , madhor e me zotesi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar:  
"SANPAOLO"Shpk. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

#### NENI 1 EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "SANPAOLO"Shpk.

#### NENI 2 SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga, Mustafa Matohiti, Pll.Nr.5,Ap.2/3 Tiranë.. Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

#### NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvèç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

#### NENI 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti veprimtarise se shoqerise do jete : Ushtrimi i veprimtarise ne fushen e studimit,projektimit,ndertimit si edhe shfrytezimit te tyre.Ndertimin e pallateve resorteve turistike,hoteleve bareve ,restoranteve si edhe banesave te cdo lloji qe lejon ligji.Prodhim tregtim ambalazhim uji natyral,lengje frutash,pije freskuese.Import-Eksport te mallrave te ndryshem industrial dhe ushqimore,pjese kembimi,automjete.Rikonstruksione ndertim objektesh,ujesjelles kanalizime,prodhim inertesh,lende drusore,veprimtari turistike hotele.Materiale ndertimi dhe lendeve te para qe kane te bejne me fushen e ndertimit.Hartim plane rregulluese,projekteve ne fushen e arkitektures.Ndertimin e urave ,autostradave,hekurudhave etj.Punime germimi nentoke e mbi toke,restaurime,veshje fasadash,vepra arti diga e tunele,ndertim te veprave energjitetike hidrike si edhe te energjise se rrinovueshme.Ofrim i sherbimeve profesionale te konsulences per individ,persona fizik e juridik shqipetar e te huaj te tilla si :konsulence ligjore,ekonomike financiare,juridike avokatie inxhinierike.Pastrim mirmbajtje dhe administrim te ambienteve te perbashketa ne bashkepronesi ne nderfesat e hanimit.objekte civile eti.Sherbim ne fushen e parkimit me naçese te automjeteve



Tregtim pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, shitje, blerje, qeradhenie, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi i Ortakut të vetëm themelues në vlerën 200,000 Lekë (DYqind mijë lekë) dhe është i përbërë nga 1 kuotë

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

**Z.Pavlin Kalusha** zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 200,000 Lekë (Dyqind mijë lekë) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisacionin në fuqi.


Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

-**Z.Pavlin Kalusha**, shtetas shqiptar, lindur me 15/03/1979, në Pukë, banues në Rrugën "Mustafa Matohiti", Pl.5.Ap.2/3, Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. personal H90315260I, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (kater) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përbajtja e Akitit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin z.Pavlin Kalusha** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### ORTAKU I VETEM THEMELUES

**Pavlin Kalusha**

